



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 1049 Prot.

Fier, më 07/03/2022

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit i Sekuestros)

PREFEKTIT TË QARKUT - FIER

Duke vlerësuar me kënaqësi bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve tona, në bashkërendimin e veprimeve për zgjidhjen e problemeve të dyanëshme, si dhe me synimin e përmbushjes së misioneve tona të ngarkuara nga Ligji, e shohim të domosdoshëm forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, pasi nga ana jonë konstatohet se në shume raste nëpërmjet Tij, është mundësuar shlyerja e borxhit doganor.

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 48/4 i Tij “Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve” - “Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre”, në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, neni 131 i Tij “Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale....”, nenit 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” - “Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të

papaguara doganore dhe të akcizës”, pika VI.3.b e Tij, “Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar, njoftimi mund të bëhet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim.....si dhe në vende publike si në Bashki, Njësi Administrative, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar”. kërkojmë nga ana Juaj :

♦ **“Shpalljen Publike”** për një periudhë kohore jo më pak se 30 (Tridhjetë) ditë të dy akteve administrativ – Vendimet e rikuperimit me forcë të detyrimeve doganore (bashkëngjitur), si vijon:

- Nr.857 Prot., datë 25.02.2022, i materializuar për subjektin “Simmons Edeco Limited” dega në Shqipëri, person juridik i regjistruar me NUIS J82916507H, me seli në Fier (Lagja “Bishanake”, Rruga “Skënderbeu”, ndërtesa në krah të djathtë të karburantit “Bolv Oil”, Kati II).
- Nr.896 Prot., datë 28.01.2022 (bashkëngjitur), i materializuar për subjektin “MARKU” sh.p.k me Nipt J64103467C, me seli në Lushnjë (Lagjja “Kadri Qystri”, Ndërtesa nr.14, hyrja nr.2), me administrator z.Zan Marku.

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes së dy akteve të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Roland Mërtiri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 857Prot.

Fier, më 25/02/2022

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve Doganore që debitori-subjekti “Simmons Edeco Limited”, me NUIS J82916507H, me seli në Fier, ka ndaj Degës së Doganës Fier”.

Dega e Doganës Fier, me aktin administrativ - Vendimin e kontabilizimit të detyrimeve doganore Nr.213, me Nr.976/5 Prot., datë 22/10/2018, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 729.628 (Shtatëqind e njëzet e nëntëmijë e gjashtëqindnjëzetetë) lekë, si dhe penalizimin në shumën 2,188,883 (Dymilion e njëqindetëdhjetë e tetëmijë e tetëqindetëdhjetetë) lekë, ndaj subjektit debitor “Simmons Edeco Limited” dega në Shqipëri, person juridik i regjistruar me NUIS J82916507H, me seli në Fier (Lagja “Bishanake”, Rruga “Skënderbeu”, ndertesa në krah të djathtë të karburantit “Bolv Oil”, Kati II).

Ky vendim i është njoftuar subjektit “Simmons Edeco Limited” ltd, me NUIS J82916507H, me seli në Fier me anë të Shërbimit Postar.

Personi juridik debitor “Simmons Edeco Limited” ltd, me NUIS J82916507H, me seli në Fier, i njoftuar, megjithëse ka kaluar afati ligjor, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 213, me Nr.976/5 Prot., datë 22/10/2018. Rezulton se subjekti ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, i cili përmes shkresës nr.30462/4 datë 29.01.2019, me lëndë “VENDIM Nr.30462/4, datë 29/01/2019, ka vendosur si vijon : “Mospranimin e ankimit Nr.30462 Prot., datë 24.12.2018, të shoqërisë “Simmons Edeco Limited” sh.p.k kundër vendimit Nr.213, datë 22.10.2018 të Degës Doganës Fier. 2.Ankesa në zbatim të pikës 8 të nenit 282 të Kodit doganor konsiderohet sikur nuk është kryer”. Më tej, nga ana e subjektit Personit juridik debitor “Simmons Edeco Limited” ltd, me NUIS J82916507H, me seli në Fier, u vijua me ngritjen e kërkesë padisë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me çështjen administrative Nr.720 Akti, datë 01.03.2019, me objekt padie “Konstatimi i pavlefshërisë absolute të vendimit Nr.213, datë 22.10.2018 të Degës Doganore Fier me nr.976/5 Prot. dhe vendimi nr.30462/4

datë 29.01.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”. Rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me Vendimin e saj Nr.302, datë 09.04.2021 (administruar në sekretarinë e Degës së doganës Fier me Nr.3791 Prot., datë 17.09.2021), ka vendosur “Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në fakte, prova e në ligj”.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr. 213, me Nr.976/5 Prot., datë 22/10/2018, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “Simmons Edeco Limited” ltd, me NUIS J82916507H, ka ndaj Degës Doganore Fier, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, *“Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”*,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumenta me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - “Simmons Edeco Limited” ltd, me NUIS J82916507H, personave të tretë, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - “Simmons Edeco Limited” ltd, me NUIS J82916507H, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personit juridik - “Simmons Edeco Limited” ltd, me NUIS J82916507H, i ka Degës së Doganës Fier, në shumën totale 2,198,511 (Dymilion e njëqind e nëntëdhjet e tetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë, sipas Vendimit Nr.213, me Nr.976/5 Prot., datë 22/10/2018, të Degës së Doganës Fier.

K R Y E T A R

Roland Mërtiri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr...896... Prot.

Fier, më 28/02/2022

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve të akcizës që debitori, subjekti “MARKU” sh.p.k me NIPT J64103467C, me seli në Lushnjë, ka ndaj Degës së Doganës Fier” .

Dega e Doganës Fier, me aktin administrativ - Vendimin Nr.3819/2 Prot., datë 17/11/2020, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit të akcizës në shumën 485,101 (Katërqind e tetëdhjet e pesëmijë e njëqindnjë) lekë, bazuar në nenin 4, pika 3, gërma “d” e Ligjit nr.61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndaj subjektit debitor “MARKU” sh.p.k me Nipt J64103467C, me seli në Lushnjë (Lagjja “Kadri Qystri”, Ndërtesa nr.14, hyrja nr.2), me administrator z.Zan Marku.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “MARKU” sh.p.k me Nipt J64103467C me anë të Shërbimit Postar. Gjithashtu, me shkresën Nr.434 Prot., date 28/01/2021, me lëndë “Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve të akcizës”, i është kërkuar subjektit likuidimi në mënyrë vullnetare i detyrimeve të akcizës dhe rezulton nga lajmërim marrje me kod bar RR616155125AA, se subjekti ka marrë dijeni më date 20.1.2021.

Subjekti juridik debitor “MARKU” sh.p.k me Nipt J64103467C, i njoftuar, megjithëse ka kaluar afati ligjor, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin e kontabilizimit të detyrimeve të akcizës Nr. 3819/2 Prot., datë 17/11/2020, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr. 3819/2 Prot., datë 17/11/2020, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “MARKU” sh.p.k me Nipt J64103467C, ka ndaj Degës Doganore Fier, bazuar në nenin 103 të Ligjit nr.61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe

Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumenta me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, subjektit - "MARKU" sh.p.k me Nipt J64103467C, personave të tretë, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, subjektit - "MARKU" sh.p.k me Nipt J64103467C, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, subjekti - "MARKU" sh.p.k me Nipt J64103467C, i ka Degës së Doganës Fier, në shumën totale **485,101** (Katërqind e tetëdhjet e pesëmijë e njëqindnjë) lekë, sipas Vendimit Nr. 3819/2 Prot., datë 17/11/2020, të Degës së Doganës Fier.

KRYETAR

Roland Mërtiri

